



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 55 Prot

Tiranë, më 29.04, 2013

VENDIM Nr. 251, dt. 29.04.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.04.2013, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i HEC Treska 2, Treska 3 dhe Treska 4 (Komuna Vithkuq dhe Kolonjë, Korçë) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "HEC TRESKA" sh.p.k., Tiranë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "HEC Treska 2, Treska 3 dhe Treska 4 (Komuna Vithkuq dhe Kolonjë, Korçë)", paraqitur nga Subjekti "HEC TRESKA" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë bazuar në kontratën dypalëshe midis "HEC TRESKA" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("HEC TRESKA" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK